

NË KREUZLINGEN TË ZVICRËS U PËRURUA OBJEKTI XHAMISË SË RE

XHAMIA E RE, VEPËR E PUNËS VULLNETARE, KU DO TË KULTIVOHET SOLIDARITETI E KULTURA FETARE

Në aktin solemn merrnin pjesë Myftiu i BI të Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë, dhe Reis ul-Ulema i BI të Maqedonisë, Sulejman ef. Rexhepi dhe kryetari i Komunës së Kreuzlingenit, Andreas Netzle të cilët edhe prenë shiritin në hyrje të xhamisë, të blerë e rinovuar me punë vullnetare nga mërgimtarët tanë. Krerët e Bashkësive islame nga Maqedonia e Kosova konstatuan se objektet e tilla të kultit, pos për kryerjen e ceremonive fetare shërbejnë edhe si qendra për kultivimin e tolerancës ndër-fetare e ndëretnike, ngase Islami është fe solidariteti dhe nuk ka asgjë të përbashkët me asnjë lloj ekstremizmi e dhune.



Imami i xhamisë së Kreuzlingenit mr. Rejhan Neziri përshëndet të pranishmit



Në mesin e mysafirëve edhe kreu i komunës dhe i kishës katolike të Kreuzlingenit



Në aktin solemn mysafirë nga Kosova, Maqedonia e mërgata shqiptare

Cyrih, 13 prill
Në qytetin e Kreuzlingenit të kantonit të Thurgaut në Zvicër në Zvicër, dje më 12 prill 2008, e u bë hapja e objektit të xhamisë së re. Në aktin solemn, merrnin pjesë krerët e bashkësive fetare nga Maqedonia, Kosova si dhe autoritetet e komunës dhe të kishës katolike të Kreuzlingenit. Në hyrje të këtij objekti sapo të rinovuar, shiritin e prenë Myftiu të BI të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, kryetari të Komunës së Kreuzlingenit, Andreas Netzle dhe Reis ul-Ulema i BI të Maqedonisë, Sulejman ef. Rexhepi. Në sallën e madhe të lutjeve ku merrnin pjesë disa qindra besimtarë dhe mysafirë shqiptarë e zviceranë, programin e prezantoi në cilësinë e moderatorit, Xhelal Qazimi: në fillim me një recitim të Kur'anit u paraqit Gani ef. Misimi, e më pastaj me një fjalë përshëndetëse të pranishmëve u drejtua imamit i xhamisë, mr. Rejhan

ef. Neziri, duke u dëshiruar mirëseardhje të gjithë të pranishmëve. Një fjalim të shkurtër e mbajti kryetari i xhamisë, Faredin Xhaferi, i cili u ndalë tek kontributi i xhamitit dhe i bamirësve të ndryshëm për blerjen dhe renovimin e objektit të ri, i cili krijon parakushte për kryerjen e ceremonive fetare e arsimore-kulturore. Ai përmendi se Xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen bën pjesë ndër xhamitë e para shqiptare që janë hapur në Zvicër, më 1 janar 1993, fillimisht në një hapësirë prej rreth 80 metrash katror. Në mars të vitit 2007 është blerë ky objekt i ri për xhami në vlerë prej 960'000 Sfr. që kap një hapësirë prej 1640 m2. Objekt të ri, përpos faltores për burra prej afro 180 mÇ, ka edhe pjesën e ndarë enkas për femra, zyrën e kryesisë e të imamit si dhe klasën për mësimin fetar dhe kafenenë, që e gjithë hapësira e brendshme kam një madhësi prej mbi 300 mÇ. Sot



Naim ef. Tërnavë, kryetari i Kreuzlingenit, Andreas Netzle dhe Sulejman ef. Rexhepi duke prerë shiritin solemn në hyrje të xhamisë së re në Kreuzlingen të Zvicrës

ky institucion fetar quhet Bashkësia Islame Shqiptare "Hëna e Re" dhe ka Statutin e saj, kryesinë e xhematit prej shtatë anëtarësh, imamin e rregullt, mr. Rejhan Nezirin si dhe një numër prej 210 anëtarësh të rregullt. Juridikisht, por jo edhe financiarisht, kjo Bashkësi, përmes Këshillit Koordinues të Bashkësive Islame të vendlindjes me seli në Cyrih, vepron në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të Bashkësive Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë dhe të Bashkësive Islame të Kosovës. Përpos faktit se kjo bashkësi vepron brenda kornizës ligjore të shtetit zviceran dhe u nënshtrohet drejtpërdrejtë dispozitave të kodit civil të tij, ajo angazhohet fuqishëm për një bashkëjetesë e mirëkuptim të mirëfilltë mes feve të pranishme këtu në Kreuzlingen. Përshëndeti gjithashtu edhe kryetari i Forumit të të Rinjve muslimanë në Kreuzlingen, Elgadat Aziri.

Kryetari i Kreuzlingenit vlerësoi lart frymën e tolerancës e bashkëpunimit

Me nga një fjalë përmbajtëse të pranishmëve iu drejtua kryetari i Komunës së Kreuzlingenit, z. Andreas Netzle, (që shoqërohej nga Arlinda Alili, përfaqësuese e komunitetit shqiptar pranë këshillit të Kreuzlingenit) i cili potencoi praninë e madhe të të huajve në këtë komunë në mesin e të cilëve një numër i familjesh me përkatësi fetare muslimane, gjegjësisht shqiptare. Pavarësisht nga përkatësitë fetare e kombëtare në këtë mjedis shumetnik mbretëron një atmo-

ferë mirëkuptimi e bashkëpunimi. Me përshëndetëse u paraqitën edhe priftit katolik, z. Matthias Loretan dhe këshilltarja për shkollë e religjion pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike, zonja Judith Borer. Në emër të imamëve të Zvicrës përshëndetën mr. Bekim ef. Alimi dhe koordinatori i BI Shqiptare në Zvicër, haxhi Sali Bajrami, pastaj përfaqësuesi i imamëve nga Gjermania, Besnik Rama., kryetari i Qendrës Islame në Gjermani e shumë mysafirë të tjerë.

Myslimanët nuk paraqesin rrezik, por begati për në Evropën

Fjalën e tij përshëndetëse Myftiu i BI të Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavës e filloi me urimin për pavarësinë e Kosovës dhe xhaminë e re në Kreuzlingen.

-Ju keni bërë një mesazh paqeje e afrie e bashkëpunimi edhe me pjesëtarët e besimeve të tjera, ngase Islami është fe solidariteti dhe që s'ka asgjë të përbashkët me ekstremizmit dhe dhunën. Kur kemi kontakte me delegacionet e huaja në Kosovë ne u themi se një 5 për qindësh në Evropë mysli-manësh është begati dhe se kjo duhet të integrohet. Kur shoh në këtë shtet një shoqëri që ka plotësuar kërkesa e juaja, duhet ti falënderojmë këtij shteti dhe këtij populli dhe Zvicrës dhe qeverisë zvicerane edhe për përkrahjen e vazhdueshme për pavarësinë Kosovës. Ndaj edhe në saje të kësaj përkrahje dhe të shumë popujve e shteteve mike unë sot me krenari mund të them: "Edhe unë kam shtet!" (duartrokijte nga të pranishmit).

Falënderim Zvicrës për tolerancë ndër-fetare e ndëretnike

Edhe fjalë përshëndetëse e Reis ul-Ulema i BI të Maqedonisë, Sulejman ef. Rexhepi, ishte plot mesazhe paqeje e falënderimi. Ai fjalën e tij e filloi me pohimin se vetëm ata që kanë imam të paluhats-hëm mund të bëjnë vepra dhe objekte të tilla të shenjta. Ai gjithashtu shprehi kënaqësinë që sot në Zvicër mbretëron një tolerancë e madhe ndër-fetare ku edhe 60 xhami, gjegjësisht qendra të kulturës islame, gjë që kjo ka bërë që mysli-manët tanë të ndihen të lirë. Ai përmendi proceset aktuale në Ballkan, duke uruar shtetin e ri të Kosovës, dhe përpjekjet e Maqedonisë për tu integruar në BE dhe NATO. Z. Sulejman ef. Rexhepi, fjalën e tij e përfundoi me konstatimin se ne me një numër kaq të madh bashkatdhetarësh ka herë jemi në Evropë. Me këtë rast shumë bamirësve dhe punëtorëve që punuan në renovimin e objektit iu ndanë mirënjohje. Mirënjohje iu ndanë edhe mysafirëve nga imami i xhamisë, duke përfshirë edhe autoritetet zvicerane. Programi i këtij manifestimi u begatua me duanë e hapjes së xhamisë nga Muftiu i Tetovës Alifekri ef. Esati, me recitim të Kur'anit nga Shaqir ef. Fetahu e Xhelal ef. Kaloshi; me këndim ilahijesh nga kori i nxënësve të xhamisë, një recitim nga aktori Daut Ameti dhe u përmbyll me namazin e drekës - nga Sami ef. Misimi, në objektin e posauruar, që është vepër e punës vullnetare të shumë mërgimtarëve tanë.

Teksti e fotot : Rexhep Rifati